

Llogaritë Kombëtare

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadate Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
5. Periudha e referencës	7
6. Mandati institucional.....	7
7. Konfidencialiteti	8
8. Politika e botimit.....	9
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes.....	10
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	10
11. Manaxhimi i cilësisë	11
12. Rëndësia.....	12
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	13
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	13
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	13
16. Kostoja dhe ngarkesa	14
17. Rishikimi i të dhënave.....	14
18. Përpunimi statistikor	15
19. Komente.....	18
Aneks	18

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Drejtoria e Llogarive Kombëtare
1.3. Personi i kontaktit	Elona Sevrani
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Drejtor, Drejtoria e Llogarive Kombëtare
1.5. Adresa postare	Rruga : Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, Albania, ZIP Code, 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	esevrani@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	26/11/2018
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	26/11/2018
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	16/04/2019
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat e llogarive kombëtare lidhen me të gjitha të dhënat e prodhuara dhe të shpërndara për një ekonomi sipas përkufizimeve dhe udhëzimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). Llogaritë kombëtare ofrojnë të dhëna për ekonominë gjithsej, por mund të përfshijnë gjithashtu ndarje të ekonomisë (në sektorë, industri, produkte, rajone, etj.). Llogaritë kombëtare sigurojnë të dhëna për disa fusha: llogari kombëtare vjetore dhe tremujore (treguesit kryesorë), llogaritë sipas sektorëve institucional, llogaritë financiare, tabela e burim-përdorimit dhe input-output, llogaritë rajonale dhe statistikat e financave të qeverisë. Një nga treguesit kryesor të llogarive kombëtare është norma e ndryshimit të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të axhustuar me efektin e çmimeve, i cili tregon zhvillimin ekonomik të një vendi, të rajonit dhe njihet gjithashtu si normë e rritjes ekonomike. INSTAT publikon të dhënat në faqen e internetit. Të dhënat e llogarive kombëtare janë paraqitur në seksionin "Ekonomia dhe financat" dhe janë organizuar si mëposhtë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • PBB e Llogarive Kombëtare • Tabela e burim-përdorimit dhe input-output • Llogaritë Rajonale në Shqipëri • Statistikat Fiskale • Statistikat Bankare • Llogaritë Vjetore nga Sektori Institucional <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>ESA 2010 ofron një metodologji mbi standardet e zakonshme, përkufizimet, klasifikimet e harmonizuara ndërkombëtarisht dhe rregullat e kontabilitetit që përdoren për përpilimin e llogarive kombëtare në baza të krahasueshme.</p> <p>ESA 2010 përcakton klasifikimet që do të përdoren për: sektorët institucionalë, transaksionet në produkte, transaksionet në aktive jo-prodhuese jo-financiare, transaksionet shpërndarëse, transaksionet në aktivet dhe detyrimet financiare, ndryshimet e tjera të aktiveve, balancimin dhe zërat me vlerë neto, bilancin kontabël, aktivet jo-financiare, aktivet dhe detyrimet financiare.</p> <p>ESA 2010 përdor dhe klasifikimeve të tjera, si : NVE Rev. 2 për aktivitete ekonomike, CPA 2008 për produkte me veprimtari ekonomike, COFOG për funksionet e qeverisë, COICOP për konsum individual, COPNI për klasifikimin e qëllimeve të institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve, NUTS 2013 për ndarjet rajonale.</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Llogaritë kombëtare përshkruajnë ekonominë gjithsej të një vendi. Të gjitha njësitë që kanë qendrën e tyre të interesit mbizotërues ekonomik në territorin ekonomik të këtij vendi, janë të përfshira. Për më tepër, përshkruhen disa ndarje të totalit. Dy nga ndarjet më të rëndësishme janë ndarja sipas sektorit institucional dhe ndarja sipas aktiviteteve të NVE Rev. 2, ku gjithpërfshirja është pjesë e padiskutuar e këtyre ndarjeve.</p> <p>Në lidhje me ndarjen sipas sektorëve institucional, ESA 2010 dallon pesë sektorë institucionalë vendorë kryesorë: (a) korporatat jo-financiare; (b) korporatat financiare; (c) qeveria e përgjithshme; (d) familjet; (e) institucione jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve. Pesë sektorët së bashku përbëjnë ekonominë gjithsej të vendit. Çdo sektor është gjithashtu i ndarë në nënsektorë.</p> <p>Sa i përket ndarjes së veprimtarisë, ESA 2010 aplikon NVE Rev.2. Aktivitetet mund të ndahen në disa nivele të detajuara, për shembull në aktivitete 3, 10, 21, 38, 64 ose 88. Në nivelin "më të lartë" përcaktohet një ndarje në 3 kategori: (a) bujqësia, pyjet dhe peshkimi; (b) minierat dhe guoret, prodhimi, furnizimi me gaz, me energji elektrike dhe me ajër të kondicionuar dhe ajri i kondicionuar, furnizimi me ujë, kanalizimet, veprimtaritë e administrimit dhe riparimit të mbetjeve, ndërtimi; (c) shërbimet.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi</p>

	referojuni seksionit 19.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Të gjitha konceptet statistikore dhe përkufizimet që do të përdoren në llogaritë kombëtare përshkruhen në Shtojcën A të Rregullores ESA 2010. Dy grupet kryesore të tabelave kanë të bëjnë me: (a) llogaritë sipas sektorëve institucional; (b) kuadri input-output dhe llogaritë sipas industrive. Llogaritë sektoriale ofrojnë, sipas sektorëve institucional, një përshkrim sistematik të fazave të ndryshme të procesit ekonomik: prodhimin, gjenerimin e të ardhurave, shpërndarjen e të ardhurave, rishpërndarjen e të ardhurave, përdorimin e të ardhurave dhe akumulimin financiar dhe jofinanciar.</p> <p>Llogaritë sektoriale përfshijnë gjithashtu bilanci për të përshkruar stoqet e aktiveve, detyrimeve dhe vlerës neto në fillim dhe në fund të periudhës së kontabilitetit. Variablat / konceptet e përshkruara në llogaritë sipas sektorëve institucional përfshijnë transaksione në produkte, transaksione në aktive jofinanciare jo të prodhuara, transaksione shpërndarëse, transaksione në aktivet dhe detyrimet financiare, ndryshime të tjera në aktive, aktivet dhe detyrimet jofinanciare dhe financiare.</p> <p>Kuadri Input-output, nëpërmjet tabelave të burim-përdorime, përcakton më në detaje procesin e prodhimit (strukturën e kostos, të ardhurat e krijuara dhe punësimin) dhe fluksin e mallrave dhe shërbimeve (prodhimi, importi, eksporti, konsumi përfundimtar, konsumi i ndërmjetëm dhe formimi i kapitalit nga grupi i produkteve). Këto variabla janë të shpërndara sipas industrive (NVE Rev. 2) dhe produkteve (CPA 2008).</p> <p>ESA 2010 përfshin gjithashtu konceptet e popullsisë dhe punësimit. Këto koncepte janë të rëndësishme për llogaritë sipas sektorëve institucional, llogaritë sipas industrisë dhe tabelat burim-përdorime. Llogaritë rajonale ofrojnë ndarje rajonale për treguesit kryesorë siç është vlera e shtuar bruto sipas industrive, formimi bruto i kapitalit fiks dhe të ardhurat e familjes.</p> <p>Ndarjet rajonale bazohen në klasifikimin NUTS. Të njëjtat koncepte të llogarive kombëtare përdoren edhe për llogaritë rajonale.</p> <p>Për më tepër, Aneksi A i Rregullores së ESA 2010 adreson dhe përcakton shumë koncepte dhe përkufizime të tjera, siç është përkufizimi i: njësive statistikore dhe grupimeve të tyre, fluksit dhe stoqeve, rregullave të kontabilitetit (vlerësimi, koha e regjistrimit, konsolidimi dhe vlera neto). Karakteristikat dhe parimet kryesore për përpilimin e llogarive kombëtare mund të gjenden në Kapitullin 1.</p> <p>Shqipëria si një vend kandidat për pranimin në BE ka filluar zbatimin e ESA 2010 gjatë vitit 2014. Llogaritë Kombëtare kanë zbatuar disa nga ndryshimet e reja metodologjike si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zgjerimi i vlerësimeve për sektorin financiar, përfshirë të gjitha institucionet financiare, për të cilat, të dhënat janë të disponueshme bazuar në klasifikimin e ri të ESA 2010 dhe SNA 2008. • Zbatimi i një metode të re për llogaritjen e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar të matur në mënyrë indirekte (FISIM). • Vlerësimi i prodhimit të Bankës së Shqipërisë, duke u bazuar në dallimin ndërmjet prodhimit të tregut dhe jo-tregut, mbështetur në SNA 2008 / ESA 2010. • Rishikimi i përkufizimit për prodhimin e kompanive të sigurimeve që

	<p>ofrojnë sigurim jo-jetë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aplikime metodologjike nën ESA 2010 për vlerësimin e treguesve të shpenzimeve (trajtimi i konsumit përfundimtar të familjeve sipas COICOP në 2 shifra, trajtimi i formimit të kapitalit fiks bruto sipas llojit të aktiveve, etj.). • Përpilimi dhe shpërndarja e tabelave të burim-përdorimit (SUT), për vitin referues 2014, në përputhje me kërkesat e programit të transmetimit të të dhënave (ESA 2010), të cilat ofrojnë një përshkrim të detajuar të një ekonomie dhe janë një instrument i rëndësishëm në analizimin dhe krijimin e modeleve statistikore . Këto tabela përshkruajnë burimet dhe përdorimet e produkteve dhe marrëdhëniet ndër-industri në ekonomi. Hartimi dhe shpërndarja e tabelave bëhet 3 vjet pas viteve të referencës (t + 3), në përputhje me kërkesat e programit të transmetimit të të dhënave (ESA 2010). Tabelat e burim-përdorimit aktualisht publikohen çdo vit, ndërsa SUT me çmime konstante (PYP) përpilohen në mënyrë eksperimentale për vitin 2013 -2015. Tabelat input-output përpilohen në bazë pesë-vjeçare (për vitet e referencës që përfundojnë me 0 dhe 5). <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>3.5. Njësia statistikore</p>	<p>Sipas udhëzimeve të ESA 2010, në llogaritë kombëtare përdoren dy lloje njësish dhe dy mënyra përkatëse të ndarjes së ekonomisë: (a) njësi institucionale; (b) njësia e llojit të veprimtarisë lokale (KAU lokale). Lloji i parë përdoret për të përshkruar të ardhurat, shpenzimet dhe flukset financiare, si dhe bilancet. Lloji i dytë i njësive përdoret për përshkrimin e proceseve të prodhimit, për analizën e input-output dhe për analizën rajonale. Një njësi institucionale është një entitet ekonomik i karakterizuar nga një autonomi vendimmarrëse në ushtrimin e funksionit të tij kryesor. Një njësi rezidente konsiderohet se përbën një njësi institucionale në territorin ekonomik, ku ka qendrën e saj të interesit kryesor ekonomik, nëse ka një autonomi vendimmarrëse dhe/ose mban një grup të plotë llogarish, ose është në gjendje të hartojë një grup të plotë llogarish.</p> <p>Në llogaritë kombëtare shqiptare, llogaria e prodhimit bazohet në njësinë e ndërmarrjes; llogaritë rajonale në LKAU. Në llogaritë e sektorit, njësia institucionale është njësia e ndërmarrjes.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>3.6. Popullata statistikore</p>	<p>Popullata e llogarive kombëtare të një vendi përbëhet nga të gjitha njësitë statistikore rezidente (njësia e ndërmarrjes, LKAU, shiko seksionin 3.5). Një njësi konsiderohet njësi rezidente e një vendi kur ka një qendër të interesit mbizotërues ekonomik në territorin ekonomik të atij vendi, domethënë kur angazhohet për një periudhë të zgjatur (një vit ose më shumë) në aktivitete ekonomike në këtë territor.</p> <p>Llogaritë kombëtare janë gjithërfshirëse. Kjo nënkupton që të gjitha njësitë statistikore rezidente janë të përfshira.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>

3.7. Zona e referencës	<p>Zona e referencës për llogaritë kombëtare është ekonomia gjithsej e një vendi. Ekonomia gjithsej e një vendi mund të ndahet në rajone. Klasifikimi NUTS siguron një ndarje të vetme, të njëtrajtshme të territorit ekonomik të Shteteve Anëtare të BE-së. Llogaritë rajonale në Shqipëri përpilohen gjithashtu sipas këtij klasifikimi, në nivel NUTS 2/3.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Të dhënat e llogarive kombëtare zakonisht përpilohen në frekuencë vjetore dhe tremujore.</p> <p>Programi i transmetimit ESA 2010 kërkon të dhëna, duke filluar prej vitit 1995 (vjetore) dhe 1995Q1 (tremujore), por aktualisht disa seri të llogarive kombëtare, fillojnë më vonë. Nëse ekzistojnë të dhëna të mëparshme, ato mund të jenë përpiluar sipas versioneve të mëparshme të ESA dhe mund të paraqesin përplasje konceptuale me ato të përpiluara nën ESA2010.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
3.9. Periudha bazë	<p>Koncepti i "periudhës bazë" nuk zbatohet në llogaritë kombëtare. Në vend të kësaj, për disa variabla të llogarive kombëtare zbatohen konceptet e çmimeve të vitit të kaluar dhe vëllimet e lidhur-zinxhir, siç përcaktohet në Vendimin e Komisionit 98/715 / EC. Llogaritja e variablave me çmimet e një viti më parë mundëson vlerësimin e indekseve të vëllimit midis periudhës kohore aktuale dhe një viti më parë. Pasi është përcaktuar periudha e referencës, indekset e vëllimit mund të lidhen zinxhir dhe më pas të aplikohen për variablat me çmimet aktuale të vitit të referencës. Kjo gjeneron vlerësime të vëllimit për çdo periudhë të analizuar.</p> <p>Aktualisht Shqipëria përdor lidhjen zinxhir të të dhënave tremujore të PBB-së me periudhën fikse të referimit (2010 = 100), duke mundësuar që periudha të ndryshme të jenë të krahasueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurojnë vlerësime për periudha afatgjata. Lidhja zinxhirë e shifrave tremujore kryhet duke përdorur teknikën Vjetore të Mbivendosijes, p.sh. vlerat e treguesve me çmimet e vitit të kaluar janë zvogëluar në nivelin e çmimit mesatar të vitit referencë të zgjedhur, duke përdorur deflatorë vjetore.</p>
4. Njësia matëse	<p>Me përjashtim të disa variablave të tilla si popullsia apo punësimi, të cilët shprehen zakonisht në numër personash, orë pune ose pozicione, sistemi ESA 2010 tregon të gjitha flukset dhe stoqet në terma monetarë: në euro ose monedhë tjetër kombëtare. Flukset dhe stoqet duhet të maten në bazë të vlerës së tyre të këmbimit, d.m.th. vlerën të cilën flukset dhe stoqet kanë në të vërtetë, ose mund të kenë, të këmbyera në para. Pra, sipas ESA 2010 vlerësimi i treguesve duhet t'u referohet çmimeve të tregut.</p>

	<p>Përveç matjes në çmimet aktuale (të tregut), disa variabla të llogarive kombëtare shprehen gjithashtu në çmimet e vitit të kaluar dhe vëllimet e lidhura zinxhir, shiko seksionin 3.9. Gjithashtu, është e mundur të përlllogariten norma rritje apo indekse, si dhe matje të tjera psh. Përqindje, të dhëna për banor, të dhëna të shprehura në standardet e fuqisë blerëse.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>5. Periudha e referencës</p>	<p>Periudha referencë, që përdoret për paraqitjen e të dhënave të llogarive kombëtare, është viti kalendarik për të dhënat vjetore dhe tremujori për të dhëna tremujore.</p> <p>Regjistrohen dy lloje bazë të informacionit: flukset dhe stoqet. Flukset i referohen veprimeve dhe efekteve të ngjarjeve që ndodhin brenda një periudhe kohe të caktuar (vit ose tremujor), ndërsa stoqet i referohen pozicioneve në një kohë të caktuar (zakonisht fillimi ose fundi i një viti ose tremujori).</p> <p>Të dhënat shqiptare përfshijnë si më poshtë: 2010 si vit referencë për llogaritë vjetore dhe T-1 si vit referencë për llogaritë tremujore.</p>
<p>6. Mandati institucional</p>	
<p>6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera</p>	<p>Llogaritë kombëtare janë përpiluar në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 2010), i cili u botua në Fletoren Zyrtare si Shtojcë A e Rregullores (BE) Nr 549/2013. Programi i transmetimit ESA 2010 është i përfshirë në Shtojcën B. ESA 2010 ka formën e një rregulloreje dhe parashikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia (Shtojca A) për standardet, përkufizimet, klasifikimet dhe rregullat e kontabilitetit që duhet të përdoren për përpilimin e llogarive dhe tabelave në baza të krahasueshme (link i lidhur me librin e metodologjisë ESA 2010); • Programi i transmetimit të të dhënave (Shtojca B), i cili përcakton afatet kohore me të cilat Shtetet Anëtare duhet të transmetojnë në Eurostat llogaritë dhe tabelat (link i lidhur me programin e transmetimit ESA 2010). <p>Përjashtime të përkohshme ndaj kërkesave të transmetimit të të dhënave, u janë dhënë Shteteve Anëtare, deri në vitin 2020, nga Vendimi i Komisionit Zbatues 2014/403 / EU i 26 qershorit 2014, duke lejuar kështu që të dhënat kombëtare të devijojnë përkohësisht nga kërkesat e transmetimit ESA 2010.</p> <p>Disa akte të tjera ligjore me rëndësi për llogaritë kombëtare janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendimi i Komisionit 98/715 i 30 Nëntorit 1998 dhe Vendimi i Komisionit 2002/990 i 17 Dhjetorit 2002 për matjen e çmimit dhe volumeve në llogaritë kombëtare. • Akti ligjor për procedurën e deficitit të tejkaluar. <p>Akte të tjera, të lidhura kryesisht me klasifikimet, të tilla si: NVE Rev.2, CPA 2008, COFOG, COICOP, NUTS 2013.</p>

	<p>Në faqen e internetit të Eurostat, nën seksionet 'Llogaritë Kombëtare' dhe 'Financat e Qeverisë dhe EDP', mund të gjenden akte të tjera ligjore, të rëndësishme për llogaritë kombëtare.</p> <p>Në Shqipëri, INSTAT është agjensia më e rëndësishme për mbledhjen e statistikave makro-ekonomike shqiptare. INSTAT merr përsipër pjesën më të madhe të mbledhjes dhe përpilimit të të dhënave, me përjashtim të Bilancit të Pagesave (BP) dhe të dhënave të sektorit bankar, të cilat janë përgjegjësi e Bankës së Shqipërisë (BSH). Statistikat e qeverisë mblidhen nga Ministria e Financave (MF). Institucioni ka në dispozicion instrumentet e mëposhtëm për të planifikuar, drejtuar dhe monitoruar aktivitetet statistikore në vend:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji për Statistikat Zyrtare • Programi 5-vjeçar i Statistikave Zyrtare • Plani Strategjik 5-vjeçar i INSTAT • Plani Operacional Vjetor i INSTAT • Raporte 3-mujore mbi ecurinë zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare • Memorandume mirëkuptimi midis INSTAT dhe homologut kryesor <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Të dhënat e llogarive kombëtare janë të dhëna të rëndësishme, të përdorura dhe të publikuara nga shumë organizata ndërkombëtare. Një iniciativë për të përmirësuar shpërndarjen e të dhënave për Llogaritë Kombëtare u fillua në vitin 2016 nga Grupi Ndër-Institucional për Statistikat Ekonomike dhe Financiare (që përfshin përfaqësues të Bankës për Zgjidhjet Ndërkombëtare, Bankën Qendrore Evropiane, Eurostat, FMN, Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore), si një iniciativë e G20 Data Gap.</p> <p>Të dhënat e llogarive kombëtare shqiptare përdoren në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga organizata të ndryshme, politikëbërës dhe analistë.</p> <p>Llogaritë Kombëtare Shqiptare raportohen në Eurostat në kuadër të Programit të Transmetimit ESA 2010, FMN, OECD, ECB dhe organizata të tjera.</p>
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkimore bazuar në Ligjin Kombëtar të Statistikave Nr.17 / 2018 "Për Statistikat Zyrtare", datë 10.03.2018 dhe Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>

	<p>Rregullorja (KE) Nr. 223/2009 për Statistikat Evropiane (neni 24 dhe neni 20 (4)) e 11 marsit 2009 (OJ L 87, f. 164), përcakton nevojën për të krijuar parime dhe udhëzime të përbashkëta për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave të përdorura për prodhimin e statistikave evropiane dhe aksesin në këto të dhëna konfidenciale për zhvillime teknike, si dhe të kërkesave të përdoruesve në një shoqëri demokratike. Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane parashikon dhe kushte të tjera që duhet të respektohen nga zyrat e statistikave në lidhje me konfidencialitetin statistikor (Parimi 5).</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Megjithëse të dhënat e llogarive kombëtare në përgjithësi shprehen në nivel të agreguar, mund të ketë raste të mundshme të identifikimit të treguesve për ekonomive të vogla. Në këto raste duhet të merren masa për të mos zbuluar të dhëna të një njësie të veçantë statistikore. Udhëzimet se si të parandaloni zbulimin mund të gjenden në Manualin për kontrollin statistikor të zbulimit.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendarin e publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p> <p>Kalendarin e publikimeve përfshin një vit të plotë kalendarik dhe të gjitha publikimet e planifikuara të llogarive kombëtare.</p>
<p>8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendarin e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>

8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me kuadrin ligjor të Komunitetit dhe Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane (Parimi 6 mbi paanshmërinë dhe objektivitetin, Parimi 13 mbi afatet dhe përpikmërinë dhe Parimi 15 për aksesin dhe qartësinë), të dhënat e llogarive kombëtare që plotësojnë standardet e cilësisë, përfshirë metadatat përkatëse, duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve.</p> <p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr.17 / 2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit të PBB janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Botime speciale (botime të shtypura të përgjithshme, Vjetar Statistikor) 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	<p>Të dhënat e reja tremujore të llogarive kombëtare publikohen çdo tremujor: 4 herë në vit. Sidoqoftë, në varësi të rrethanave dhe praktikave kombëtare, të dhënat e lëshuara fillestare tremujore të llogarive kombëtare mund të rishikohen dhe shpërndahen përsëri.</p> <p>Të dhënat vjetore të llogarive kombëtare publikohen të paktën një herë në vit: kur të dhënat për një vit të ri shtohen. Por, në varësi të praktikave të vendit dhe politikës së rishikimit, të dhënat vjetore gjithashtu mund të publikohen më shpesh, p.sh. publikimi i një vlerësimi të përkohshëm në fillim të vitit kalendarik dhe një i rishikuar më vonë gjatë vitit kalendarik.</p> <p>Për shpeshësinë e shpërndarjes, ju lutemi shikoni politikën shqiptare të revizionimit.</p>
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Rezultatet më të rëndësishme të llogarive kombëtare publikohen në lajme. Të dhënat e reja të llogarive kombëtare mund të paraqiten gjithashtu në konferenca për shtyp. Datat e sakta janë shpallur më parë në kalendarin e publikimeve (shiko seksionin 8.1 më lart).</p>
10.2. Publikime	<p>Përveç njoftimeve për shtyp, të dhënat e llogarive kombëtare mund të shpërndahen në botime të tjera, siç janë gazetatat statistikore, vjetarët statistikorë, artikujt e brendshëm dhe të jashtëm. Zakonisht kjo ka të bëjë me botime në të cilat kryhet një analizë më e thelluar.</p>
10.3. Baza e të dhënave on-line	<p>Për të mundësuar një akses sa më të lehtë në të dhënat e llogarive kombëtare, të gjitha të dhënat e vlefshme të llogarive kombëtare duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve duke i publikuar ato në një bazë të dhënash në internet. Të gjitha të dhënat në bazën e të dhënave statistikore janë të disponueshme në shqip dhe</p>

	anglisht në linkun: Baza e të dhënave statistikore shqiptare .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Nuk aplikohet.
10.5. Të tjera	Përveç njoftimeve për shtyp dhe publikimeve të tjera (shiko seksionet 10.1 dhe 10.2), informacionet mbi llogaritë kombëtare mund të postohen duke përdorur media sociale.
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Kuadri i përgjithshëm metodologjik për përpilimin e llogarive kombëtare në BE është ESA 2010.</p> <p>Gjithashtu, janë hartuar disa manuale për të ndihmuar hartuesit për të prodhuar të dhëna të llogarive kombëtare. Disa nga manualët më të rëndësishme metodologjike janë Manuali mbi llogaritë kombëtare tremujore, Manuali për metodat e llogarive rajonale, Manuali i Eurostat mbi tabelat burim-përdorime dhe input-output, Manuali mbi defiçitin e qeverisë dhe borxhet. Gjithashtu, manualët udhëzues për tema specifike janë në dispozicion, p.sh. Udhëzues për përpilimin e vlerësimit të tokës, udhëzues për përpilimin e inventarëve, Manual për matjen e Kërkimit dhe Zhvillimit në ESA 2010.</p> <p>Manualët e mësipërm zbatohen posaçërisht për statistikat e llogarive kombëtare të BE-së. Sidoqoftë, ekuivalentët në të gjithë botën shpesh janë gjithashtu të disponueshëm: SNA 2008, Manuali i Llogarive Kombëtare Tremujore, Manuali mbi Përmbledhjen dhe Analizën e Tabelave të Input-Output, Manuali i Statistikave të Financave të Qeverisë.</p> <p>Dokumentacioni mbi burimet dhe metodat është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Rëndësia e llogarive kombëtare kërkon që dokumentacioni të jetë i disponueshëm për procedurat e përdorura për menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimin e cilësisë. Shembuj të dokumentacionit të tillë janë raportet e cilësisë së llogarive kombëtare, studimet e cilësisë dhe raportet mbi analizën e rishikimit.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit,

	<p>efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p> <p>Cilësia e të dhënave të llogarive kombëtare sigurohet me zbatimin e rreptë të koncepteve të ESA 2010, si dhe duke zbatuar udhëzimet e manualit ESS për raportet e cilësisë.</p> <p>Gjatë procesit të përgjithshëm të përpilimit, të dhënat e llogarive kombëtare dhe rajonale i nënshtrohen disa llojeve të kontrolleve të cilësisë, p.sh. ex-ante (statistikat e burimit), ongoing/në vazhdim (rezultatet), ex-post (metodat e përdorura) dhe kontrollet e jashtme (Eurostat, Gjykata Evropiane ose Kombëtare e Auditorëve, FMN).</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>11.2. Vlerësimi i cilësisë</p>	<p>Praktika kombëtare mund të raportohet, për shembull duke siguruar një lidhje me raportin kombëtar të cilësisë dhënë nga Eurostat ose raporte të tjera të lëshuara në shkallë kombëtare (ose duke siguruar një përshkrim të përmbledhur të përmbajtjes së tij).</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>12. Rëndësia</p>	
<p>12.1. Nevojat e përdoruesit</p>	<p>Llogaritë kombëtare ofrojnë informacione kryesore për monitorimin e politikave ekonomike, vendimmarrje, për parashikime, për qëllime administrative, për informimin e publikut të gjerë rreth zhvillimeve ekonomike (direkt ose indirekt përmes agjencive të lajmeve) dhe si input për studime ekonomike.</p> <p>Në nivelin kombëtar, ministritë e financave, të ekonomisë dhe zhvillimit rajonal, komunitetet shkencore dhe akademike dhe studiuesit ekonomikë janë zakonisht përdoruesit kryesor të të dhënave të llogarive kombëtare dhe rajonale.</p> <p>Institucionet ndërkombëtare janë gjithashtu përdorues të të dhënave të llogarive kombëtare. Institucionet ndërkombëtare mund të konsiderohen si "klientë" të IKS.</p>
<p>12.2. Kënaqësia e përdoruesit</p>	<p>Pikëpamjet dhe opinionet e përdoruesve të statistikave të Llogarive Kombëtare mund të mblidhen dhe analizohen si një mjete për të "matur" rëndësinë e të dhënave të Llogarive Kombëtare. INSTAT zhvilloi "Vrojtimin e kënaqësisë së përdoruesit", për herë të parë në 2017. Është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat dhe opinionet e përdoruesve, të cilat mund të integrohen në procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Për përshkrime më të hollësishme të ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>12.3. Plotshmëria</p>	<p>Në shumicën e vendeve, llogaritë kombëtare mbulojnë agregatet kryesore të llogarive kombëtare, llogaritë e qeverisë, llogaritë sektoriale, llogaritë rajonale dhe tabelat e burim-përdorimit. Sidoqoftë, përmbajtja e të dhënave për këto fusha si dhe (detajet e) ndarjet e ndryshme (sipas rajonit, sektorit, industrisë,</p>

	<p>produktit, etj.), mund të jenë të ndryshme në vende të ndryshme, në varësi të nevojave kombëtare dhe burimeve të disponueshme. Programi i transmissiionit ESA 2010, i përbërë nga 22 tabela në të gjitha fushat e llogarive kombëtare (shiko seksionin 10.3), përcakton grupin minimal të të dhënave të Llogarive Kombëtare që duhet të jenë të disponueshme në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Praktika kombëtare mund të plotësohet: duke iu referuar raporteve të cilësisë dhe më saktë analizës së rishikimit në raportet e cilësisë. Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Nuk aplikohet.
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	<p>Të dhënat e llogarive kombëtare duhet të jenë të disponueshme për përdoruesit sa më parë, duke marrë parasysh shpeshtësinë e të dhënave (vjetore ose tremujore), karakterin e të dhënave (informacione mbi strukturën e një ekonomie ose mbi zhvillimet e konjukturës) dhe një ekuilibër të duhur ndërmjet saktësisë dhe afatit kohor.</p> <p>Programi i transmetimit ESA 2010 përcakton afatet e duhura kohore për të gjitha tabelat e llogarive kombëtare. Tabelat tremujore bëhen të disponueshme 3 muaj pas përfundimit të tremujorit. Tabelat vjetore duhet të transmetohen midis 2 muajve (treguesit kryesorë) dhe 36 muajve (tabela e burim-përdorimit) pas përfundimit të vitit të referencës.</p> <p>https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:L:2014:195:FULL&from=EN</p>
14.2. Përpikmëria	<p>Datat në të cilat të dhënat e llogarive kombëtare bëhen të disponueshme duhet të jenë të paracaktuara dhe të përputhen me datat e publikimit.</p> <p>Transmetimet e të dhënave të llogarive kombëtare në kuadrin e programit të transmetimit ESA 2010 duhet të dorëzohen me përpikëri në Eurostat në kohën e përcaktuar në programin e transmetimit (ose më parë).</p>
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Krahasueshmëria gjeografike e llogarive kombëtare në Shtetet Anëtare të BE-së sigurohet me aplikimin e përkufizimeve të përbashkëta të Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010). Krahasimi gjeografik është gjithashtu i mundur në të gjithë botën, pasi shumica e vendeve jo-evropiane zbatojnë udhëzimet e SNA</p>

	2008 dhe SNA 2008 është në përputhje me ESA 2010.
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Duke qene se të dhënat për të gjitha periudhat e referencës vlerësohen sipas kërkesave të ESA 2010, të dhënat e llogarive kombëtare janë plotësisht të krahasueshme. Gjithashtu, në rastet e ndryshimeve themelore të metodave apo klasifikimeve, bëhen rishikime të serive të gjata kohore, zakonisht duke shkuar shumë mbrapa në kohë.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Brenda sistemit të llogarive kombëtare ka një përputhje të plotë ndërmjet fushave: llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore, llogaritë qeveritare, llogaritë e sektorëve, llogaritë financiare, llogaritë rajonale, tabelat burim-përdorime. Megjithatë, në praktikë, konsistenca e plotë mund të mos jetë gjithmonë e mundur dhe mund të shfaqen mospërputhje të përkohshme. Ato zakonisht janë rezultat i ndryshimeve të vjetra. Statistikat kryesore si, statistikat strukturore të biznesit (SBS-eng), statistikat afatshkurtra (STS-eng) dhe statistikat e forcave të punës (LFS-eng) përdoren gjerësisht si input për llogaritë kombëtare. Sidoqoftë, nuk ka konsistencë të plotë ndërmjet këtyre fushave statistikore dhe llogarive kombëtare. Arsyet kryesore janë ndryshimet në koncepte / përkufizime dhe në mbulim. Bilanci i pagesave përdoret gjithashtu si një burim i rëndësishëm për llogaritë kombëtare. Përkufizimet dhe mbulimi i bilancit të pagesave, siç përcaktohet në manualin BPM6, janë plotësisht të harmonizuara me ato të ESA 2010. Prandaj, variablat e bilancit të pagesave, në parim, janë plotësisht koherente me variablat përkatëse të llogarive kombëtare.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni lidhjeve më poshtë në seksionin 19.</p>
15.4. Koherenca e brendshme	Shihni seksionin 15.3 (Koherencë – ndërmjet fushave).
16. Kostoja dhe ngarkesa	I padisponueshëm.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Duke qene se të dhëna të reja bëhen të disponueshme, treguesit e llogarive kombëtare i nënshtrohen rishikimeve të vazhdueshme . Ato quhen rishikime të zakonshme dhe sjellin rishikime të rregullta të të dhënave të vendit dhe të treguesve evropiane, të cilat rrjedhin nga ato të mëparshme. Treguesit e llogarive kombëtare mund t’u nënshtrohen rishikimeve madhore (të quajtura rishikime benchmark, të cilat ndodhin si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha në burimet e të dhënave, klasifikime ose metodologjia. Këto rishikime ndodhin më rrallë. Për shembull, kalimi nga ESA95 në ESA 2010, solli një rishikim madhor në nivelin vendi dhe në nivelin e të dhënave të zonës euro / BE. Dy Task Forca hartuan propozime për një qasje më të harmonizuar të standardeve dhe rishikimeve të zakonshme. Njëra, nën kujdesin e Drejtorëve të Statistikave Makroekonomike (DMES-eng), trajtoi politikën e rishikimit të standardeve, tjetra, nën kujdesin e Komisionit për Statistikat Monetare, Financiare dhe të Bilancit të Pagesave</p>

	<p>(CMFB-eng), trajtoi Politikën Evropiane të Harmonizuar të Rishikimeve.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Ndërkohë që rishikimet duhet të shihen si një proces për të përmirësuar në mënyrë progresive cilësinë e llogarive kombëtare si p.sh. burime më të mira dhe / ose metoda të tjera të bëhen të disponueshme, disponueshmëria e metadatave për këto rishikime është një element kryesor për të kuptuar të dhënat e llogarive kombëtare dhe rishikimet e ndërmjet publikimeve.</p> <p>Si rrjedhojë, kërkohet informacion mbi arsyet kryesore të rishikimeve dhe natyrën e tyre (të dhëna të reja burimesh të disponueshme, metoda të reja, etj), si dhe mundësisht vlerësim sasior dhe cilësor për masën mesatare të rishikimeve dhe drejtimin e tyre bazuar në të dhënat historike.</p> <p>Rishikimet tremujore, lidhen me rishikimet rutinë tremujore pasi të dhënat shtesë bëhen të disponueshme për tremujorin e fundit. Ato kanë ndikimin e tyre në tremujorët e mëparshëm sepse: të dhënat e raportuara për tremujorët e fundit mbështeten nga të dhëna të shtesë ose bëhen përmirësime / korrigjime të të dhënave për tremujorët e mëparshëm. Është e nevojshme të përmendet që shumica e të dhënave të përdorura për vlerësimet tremujore janë të dhëna administrative. Përfshirja e të dhënave të tremujorit të fundit në seri dhe zbatimi pasues i përshtatjes sezonale do të ndryshojë tremujorët e mëparshëm.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Vlerësimi i llogarive kombëtare dhe rajonale bazohet në statistika që kryesisht mbliidhen për qëllime të tjera (statistikat parësore).</p> <p>Ato mbështeten në një shumëllojshmëri të burimeve të të dhënave, përfshirë të dhënat administrative: regjistrat e makinave dhe biznesit, pasqyrat e llogarive kontabel, të dhënat tatimore, raportet buxhetore, regjistrimet e popullsisë, anketimet statistikore të bizneseve dhe familjeve, deklaratat e institucioneve mbikëqyrëse dhe organizatat, raportet vjetore dhe tremujore, statistikat e tregtisë për mallrat dhe shërbimet, informacioni mbi bilancin e pagesave.</p> <p>Nuk ka një vrotim të veçantë për llogaritë kombëtare. Burimet ndryshojnë nga një vend në tjetrin dhe japin informacione statistikore për një grup të madh fenomenesh ekonomike, sociale, financiare dhe mjedisore, të cilat mund të mos jenë të lidhura direkt me llogaritë kombëtare.</p> <p>Burimet dhe metodat e grumbullimit të përdorura në secilin vend ndryshojnë në varësi të të dhënave specifike. Në përgjithësi, është e vështirë të jesh gjithëpërfshirës në renditjen e burimeve të të dhënave. Dokumentimet që dërgohen në Eurostat zakonisht përfshijnë informacione mbi burimet kryesore (shiko seksionin 10.6).</p> <p>Informacione të mëtejshme mbi burimet e të dhënave mund të gjenden në faqet kombëtare të internetit. Ju lutemi shikoni inventarin GNI për më shumë</p>

	<p>informacion.</p>
<p>18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Llogaritë kombëtare zakonisht përpilohen mbi baza vjetore ose tremujore nga statistikat e tjera parësore.</p> <p>Frekuenca e mbledhjes së të dhënave të statistikave parësore ndryshon në bazë të natyrës së burimit të të dhënave. Për shembull, statistikat e biznesit zakonisht janë të disponueshme në baza mujore (dhe tremujore). Disa anketa pranë familjeve janë të disponueshme në frekuencë tremujore ose vjetore (ndonjëherë edhe më pak të shpeshta). Disponueshmëria e të dhënave administrative ndryshon nga një vend në tjetrin. Regjistrimet e popullsisë kryhen zakonisht çdo 10 vjt. Frekuenca dhe koha e përpilimit të llogarive kombëtare nuk janë domosdoshmërisht në përputhje me frekuencën dhe kohën e mbledhjes së të dhënave primare të statistikave.</p> <p>Llogaritë Kombëtare zakonisht marrin / mbledhin informacion bazuar në planin e tyre, d.m.th. për vlerësimet e tyre vjetore ose tremujore. Vendet mund të japin një përshkrim të kohës së marrjes së të dhënave të jashtme.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Mbledhja e të dhënave është shumë specifike për çdo shtet dhe gjithashtu ndryshon në bazë të natyrës së burimit të të dhënave, p.sh. të dhëna administrative, regjistrat e taksave dhe makinave, anketat, pasqyrat e llogarive kontabël. Udhëzimet mund të gjenden në manualin e praktikave të rekomanduara për zhvillimin e pyetësorëve dhe metodat e testimit në ESS.</p> <p>Drejtoritë e Llogarive Kombëtare zakonisht nuk mbledhin vetë të dhëna, por i marrin ato nga departamente ose institucione të tjera. Vendet mund të japin një përshkrim më të hollësishëm të rrugëve me të cilat mblidhen të dhënat e jashtme.</p> <p>Udhëzimet ESS sugjerojnë që metodat e përdorura për mbledhjen e të dhënave duhet të përshkruhen. Mund të jetë e përshtatshme që seksioni të plotësohet edhe me çështjet e mëposhtme: (i) një Institut Kombëtar Statistikash zakonisht nënshkruan një marrëveshje dhe protokoll teknik për bashkëpunim me institucionet e tjera mbi çfarë, kur, si, te dhënat do të shpërndahen.; (ii) departamenti i llogarive kombëtare gjithashtu merr pjesë në zhvillimin e pyetësorëve të anketave statistikore të departamenteve të tjera.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Vlerësimi i të dhënave i referohet çdo aktiviteti që synon të verifikojë se vlera e një të dhëne vjen nga një grup vlerash të pranueshme. Është një detyrë kryesore që kryhet në të gjitha fushat statistikore dhe veçanërisht e rëndësishme për llogaritë kombëtare, të cilat janë një bazë e të dhënave kryesore për analizën ekonomike dhe vendimmarrje politike.</p> <p>Për të rritur cilësinë e përgjithshme të të dhënave dhe efikasitetin e punës, Sistemi Evropian i Statistikave (ESS) po shkon drejt harmonizimit të</p>

	<p>aktiviteteve të vlefshmërisë, përfshirë përkufizimin e standardeve, mjeteve dhe ndihmave të përbashkëta për zbatimin e tyre (shiko faqen e internetit të ESS). Llogaritë kombëtare janë një pilot në këtë fushë. Një Task Force ESA 2010 për vlefshmërinë u krijua në vitin 2015 për të dakordësuar dhe dokumentuar rregullat e vlefshmërisë në një manual të veçantë ESA 2010 dhe t'i zbatojë ato në mënyrë progresive në një proces paraprak vlerësimi për të dhënat e llogarive kombëtare.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Burimet e të dhënave, metodat dhe teknikat e përpilimit janë specifike për çdo vend, por ato duhet të përdoren në atë mënyrë që të përputhen me përkufizimet dhe konceptet në ESA 2010. Shumë dokumente udhëzuese janë në dispozicion për çështje të përgjithshme dhe specifike të mbledhjes së të dhënave të Llogarive Kombëtare.</p> <p>Metodat kryesore për të vlerësuar Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) në kuadrin e Llogarive Kombëtare vjetore në Shqipëri janë metoda e prodhimit dhe shpenzimeve. Konsistenca realizohet nëpërmjet procesit të bashkërendimit. Veçanërisht, ndryshimet në inventarë konsiderohen si diferencë.</p> <p>Një metodë tjetër përdoret për përpilimin e Llogarive Kombëtare tremujore. Llogaritë sektoriale përpilohen pas agregatëve kryesore.</p> <p>Të dhënat e llogarive kombëtare janë përgjithësisht të qëndrueshme. Për informacion të mëtejshëm, shihni gjithashtu seksionet 10.6. dhe 17.1.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni lidhjeve më poshtë në seksionin 19.</p>
<p>18.6. Rregullimi</p>	<p>Qëllimi kryesor i përshtatjes sezonale është të identifikojë dhe eliminojë efektet sezonale dhe kalendarike, në seritë kohore aftashkurtra dhe afatgjata dhe japin një kuptim të qartë të dukurive themelore.</p> <p>Përshtatja sezonale është një proces themelor në interpretimin e serive kohore për të informuar politikëbërësit (udhëzimet ESS për përshtatjen sezonale, Edicioni 2015, Shtojca, pika 1).</p> <p>Për të dhëna të përzgjedhura të llogarive kombëtare, të tilla si treguesit kryesore tremujore, seritë kohore zakonisht publikohen jo vetëm në formën e tyre të pa përshtatur, por edhe sipas llojeve të ndryshme përshtatjeje (psh. sezonale, kalendarike dhe sipas ciklit të trendit). Në të njëjtën formë duhet të transmetohen edhe në përmbushje të Programit të Transmetimit ESA 2010, përveç treguesve tre-mujorë me çmimet e vitit të kaluar.</p> <p>Transmetimi i të dhënave tremujore që përfshijnë përshtatjen e efekteve kalendarike është vullnetar. Ndërsa për llogaritë sektoriale, përshtatja sezonale (përfshirë rregullimet e kalendarit, kur është e nevojshme) është e detyrueshme për një seri kohore të kufizuar.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare të Shqipërisë, ju</p>

	lutemi referojuni seksionit 19.
19. Komente	Nuk ka komente.
Aneks	
<p><u>Përpilimi i të Ardhurave Kombëtare Bruto</u></p> <p><u>Matja e Cmimeve dhe Volumit</u></p> <p><u>Implementimi i Esa 2010 dhe NVE Rev.2_Albania</u></p> <p><u>Përpilimi i Llogarive Kombëtare Tremujore</u></p> <p><u>Llogaritë Rajonale</u></p> <p><u>Llogaritë Vjeore sipas Sektorëve Institucional</u></p> <p><u>Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve</u></p> <p><u>Statistikat Financiare</u></p> <p><u>Statistikat Bankare</u></p> <p><u>Kalendari i Publikimeve</u></p> <p><u>Politikat E Revizionimit</u></p> <p><u>Politika E Trajtimit Të Gabimeve</u></p> <p><u>Përpilimi I Tabelave Të Burim-Përdorimit Dhe Input-Output</u></p> <p><u>Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021</u></p> <p><u>Ligji Për Statistikat Zyrtare</u></p> <p><u>Strategjia E Zhvillimit Të Instat 2017-2030</u></p> <p><u>Plani Operacional Vjetor</u></p>	